

**TERMAT E REFERENCËS PËR
STAFIN MBËSHTETËS KOMUNAL – KONSULENTËT
(PËR MBLEDHJEN DHE PËRDITËSIMIN E TË DHËNAVE TË ADRESAVE)¹**

1. Hyrje

Përcaktimi i adresave të ndërtesave, me sinjalizimin e emrave të rrugëve dhe numrave të adresave, si dhe krijimi i një regjistri adresash, kishte filluar në vitin 2010. Me financimin e kredisë së Bankës Botërore, puna duhet të përfundojë për të gjitha komunat gjatë vitit të ardhshëm. Pjesa më e madhe e punës do të bëhet në nivel lokal në komuna. Agjencia Kadastrale e Kosovës do të rekrutojë dhe paguajë gjithsej 55 konsulentë për të ngritur kapacitetet e komunave për të kryer këtë punë. Në fazën e parë dhe të dytë janë përzgjedhur 48 kandidatë dhe janë kanë mbetur 6 anëtarë të tjerë të stafit për t'u përzgjedhur.

Konsulentët shpërndahen nëpër komuna sipas tabelës së mëposhtme, për të punuar në një nga komunat e listuara për një periudhë gjashtëmujore. Kandidatët duhet të cekin komunën ose komunat (deri në tri) për të cilat aplikojnë.

Gjendja aktuale:

Projekti i krijimit të Sistemit të Adresave kishte filluar në vitin 2010 dhe vazhdon të zbatohet edhe tani.

Aktivitetet e realizuara gjatë viteve 2010-2021 janë:

- Përgatitja e bazës ligjore (Ligji për Sistemin e Adresave, pesë Udhëzime Administrative dhe Manuali i Adresave),
- Ngritja e kapaciteteve në nivel komunal dhe qendror,
- Zhvillimi dhe instalimi i një Regjistri modern të Adresave të bazuara në ueb (ARIS) në AKK,
- Mbledhja e të dhënave dhe digjitalizimi i informacionit për Zonat e Qarkullimit Publik (ZQP), rrugët, sheshet, parqet, bulevardet, etj.
- Mbledhja e informacionit në lidhje me hyrjet e ndërtesave në terren dhe regjistrimi i numrave të adresave përkatëse në ARIS (rreth 450,000 hyrje)
- Emërtimi i rrugëve në 33 komuna,
- Sinjalizimi me tabela emërtuese në 31 komuna,
- Sinjalizim me tabela me numra të hyrjeve në 12 komuna,

¹ Për më shumë informacione shihni linkun në vijim:

<http://www.kca-ks.org/urdheresa-administrative>,

<http://www.kca-ks.org/documents/10179/1737436/Doracaku+i+Adresave.pdf/e79e3e3a-73bb-4218-a903-1bd26e3788da>.

- Ndarja e të dhënave të adresave në 16 institucione vendore dhe ndërkombëtare, si TomTom dhe OpenStreetMap,

2. Aktivitetet për kompletimin e sistemit të adresave për Kosovën

Një proces shumë i rëndësishëm për Sistemin e Adresave është kompletimi i Regjistrit digjital të Adresave, nëpërmjet mbledhjes së të dhënave në terren. Mungesa e përditësimit të regjistrit të adresave nga komunat po shkakton shumë probleme për përdoruesit e regjistrit të adresave. Departamentet Komunale për Urbanizëm do të jenë akterët kryesorë përgjegjës për planifikimin dhe zbatimin e projektit për kompletimin e sistemit të adresave në Kosovë.

Projekti i përditësimit të të dhënave të adresave ka të bëjë me mbledhjen e të dhënave të adresave që mungojnë në regjistrin e adresave dhe përditësimin e regjistrit në përputhje me rrethanat. Ky proces do të zhvillohet në 34 komuna, duke përfshirë 4 komunat veriore.

Procesi i kompletimit të regjistrit të adresave përbëhet nga tre komponentë kryesorë:

- I. **Përditësimi i hyrjeve që duhet të kenë një numër të adresës sipas zhvillimeve në terren.** Të dhënat për hyrjet që duhet të kenë adresë nuk janë përditësuar rregullisht nga viti 2012. Informacionet për hyrjet në ndërtesat e ndërtuara nga viti 2012 e deri më tani, dhe të cilat nuk janë identifikuar, duhet të mblidhen në terren, të numërohen dhe të regjistrohen në Regjistrin e Adresave (ARIS).
- II. **Mbledhja e adresave brenda në ndërtesa** - regjistrimi i adresave të brendshme, siç janë banesat dhe objektet afariste, është një tjetër proces i rëndësishëm, ku duhet të mblidhen të dhënat për katet dhe banesat në ndërtesat kolektive. Hyrjet në banesa dhe lokale afariste duhet të numërohen dhe regjistrohen në ARIS.
- III. **Mbledhja dhe regjistrimi i informacioneve në lidhje me tabelat e emrit të rrugëve të të dhënave përkatëse në ARIS** - Procesi i sinjalizimit të adresave është një nga proceset më të rëndësishme. Gjatë kësaj faze është e rëndësishme mbledhja dhe digjitalizimi i të dhënave të rëndësishme të tabelave me emrat e rrugëve. Pas mbledhjes dhe digjitalizimit të të dhënave të tabelave me emrat e rrugëve, është gjithashtu e nevojshme që komunat të mbështeten në inspektimin e procesit të vendosjes së tabelave me emrat e rrugëve dhe tabelave me numra e adresave.

I. Përditësimi i hyrjeve sipas zhvillimeve në terren

Ky proces përfshin mbledhjen e pikave të adresave që mungojnë për objektet e shqyrtuara, që janë pika që japin informacione për vendndodhjen e hyrjeve të ndërtesave etj. dhe caktimin e numrave të adresave të tyre. Pikat duhet të tregohen në hartat në letër në terren për punë të mëvonshme në zyrë për digjitalizimin e pikave dhe dhënien e numrave duke përdorur sistemin e GIS-it.

II. Mbledhja, numërimi dhe regjistrimi i adresave brenda ndërtesave

Mbledhja dhe regjistrimi i adresave të brendshme është një tjetër aktivitet i rëndësishëm për kompletimin e Sistemit të Adresave. Për ndërtesat kolektive, një adresë është ose do të caktohet për çdo hyrje në katin përdhes. Përveç kësaj, duhet të caktohen numra për hyrjet e banesave ose zyrave, siç ndodh brenda ndërtesave kolektive, gjatë procesit pasues të brendshëm të numërimit dhe regjistrimit të numrave në ARIS. Informacionet për hyrjet e brendshme të banesave dhe lokaleve afariste/hapësirave për zyre në ndërtesat kolektive duhet të mblidhen, hyrjet duhet të numërohen dhe të digjitalizohen në ARIS.

III. Mbledhja dhe regjistrimi i të dhënave lidhur me tabelat me emrat e rrugëve

ARIS duhet të ketë informacione për lokacionin dhe të dhëna të tjera relevante për tabelat me emrat e rrugëve. Të dhënat e tilla aktualisht mungojnë kryesisht në ARIS. Procesi i sinjalizimit të adresave është një nga proceset më të rëndësishme. Gjatë kësaj faze është e rëndësishme mbledhja dhe digjitalizimi i të dhënave të rëndësishme të tabelave me emrat e rrugëve. Pas mbledhjes dhe digjitalizimit të të dhënave të tabelave me emrat e rrugëve, është gjithashtu e nevojshme që komunat të mbështeten në inspektimin e procesit të vendosjes së emrave të rrugëve dhe tabelave me numra e adresave.

3. Rekrutimi i stafit ndihmës komunal – Konsulentëve

Konsulentët do të punojnë kryesisht në tri aktivitetet e përmendura më sipër, por gjithashtu mund të caktohen në aktivitete të tjera që ndërlidhen me adresat. Puna e konsulentëve përshkruhet në detaje më tej në pikën 3.2. më poshtë.

3.1 Shpërndarja e konsulentëve nëpër komuna

Konsulentët shpërndahen nëpër komuna sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Rajoni	Komuna	Numri i stafit mbështetës komunal
1	Pejë	Pejë	1
2		Istog	1
3		Klinë	1
4	Prizren	Prizren	3
5	Ferizaj	Shtërpçë	1
Gjithsej			7

Kandidatët që aplikojnë për punë si konsulentë duhet të cekin komunën e tyre të preferuar për kryerjen e punës së tyre. Kandidatët mund të cekin deri në tri komuna sipas renditjes së prioriteteve.

3.2. Detyrat specifike të stafit mbështetës komunal – konsulentëve janë:

- Njohuri për Ligjin dhe Udhëzimet Administrative dhe Manualin për Sistemin e Adresave;
- Njohuri për ARIS;
- Mbledhja e të dhënave të adresave në terren;
- Digjitalizimi i të dhënave të adresave të mbledhura në terren në ARIS në përputhje me Ligjin dhe Udhëzimet Administrative dhe metodologjinë në fuqi;
- Mbledhja dhe regjistrimi i të dhënave të attributeve për secilën adresë;
- Kryerja e kontrollit të cilësisë së të dhënave të adresave;
- Digjitalizimi i tabelave të rrugëve në ARIS në përputhje me Udhëzimet Administrative dhe metodologjinë në fuqi;
- Caktimi i attributeve për çdo tabelë të rrugëve në ARIS;
- Përgatitja e një harte me tabelat e rrugëve për secilën komunë në format digjital dhe mbështetja e AKK-së dhe komunave për printimin e hartave të kërkuara;
- Mbledhja dhe digjitalizimi i të dhënave të tabelave me emrat e rrugëve në ARIS;
- Mbështetja e komunave në inspektimin e procesit të vendosjes së tabelave të adresave (emrat e rrugëve dhe tabelat e numrave të adresave)
- Aktivitete të tjera që lidhen me kompletimin e sistemit të adresave.

Trajnimet përkatëse të konsulentëve do të ofrohen nga AKK.

4. Kushtet e punës

Stafi mbështetës komunal – konsulentët e kontraktuar do të punojnë me orar të plotë në një komunë për një periudhë kohore deri në 6 muaj. Puna kryhet në zyrë dhe në terren. Konsulenti do t'i raportojë Drejtorit të Drejtoratit për Urbanizëm të komunës përkatëse, i cili gjithashtu do të përgatisë planin e përgjithshëm të punës dhe do të mbikëqyrë punën e përditshme. Komuna është përgjegjëse për sigurimin e hapësirave për zyre, qasjen në kompjuter dhe pajisje të tjera, si dhe transportin e nevojshëm për punën në terren.

5. Përgatitja e nevojshme arsimore dhe përvoja e punës

- Kualifikimet e detyrueshme:
 - Diplomë universitare (minimumi Baçelor) në Gjeografi, Gjeodezi ose në fusha të tjera të ngjashme;
- Kualifikimet e preferuara (pikat për vlerësimin tregohen në kllapa):
 - Përvojë në punë dhe mbledhje të të dhënave gjeohapësinore dhe navigim me hartë në terren;
 - Përvojë pune në sistemin e adresave dhe sinjalizimin përkatës;
 - Përvoja nga puna me çështje të tjera teknike në komuna;
 - Njohuri bazë në teknologjinë e informacionit, preferohet njohuri në sistemet e GIS-it;
 - Njohuri të çështjeve komunale me prioritet për punë

6. Procesi i përzgjedhjes

Individët me përvojë dhe të kualifikuar do të përzgjidhen sipas dispozitave të Rregulloreve të Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e Financimit të Projekteve Investuese (FPI), korrik 2016, bazuar në thirrjen e hapur.

Agjencia Kadastrale e Kosovës është e përkushtuar ndaj parimeve të mundësive të barabarta të punësimit dhe po ashtu është e përkushtuar që të marrë vendime për punësim në bazë të meritave. Jemi të përkushtuar të zbatojmë ligjet e shtetit që ofrojnë mundësi të barabarta të punësimit, si dhe të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me kushtet e punësimit. Agjencia dëshiron të mbajë një mjedis pune pa ngacmime seksuale ose pa diskriminime në bazë të racës, fesë, ngjyrës, origjinës kombëtare, orientimit seksual, aftësive të kufizuara fizike dhe mendore, statusit martesor, moshës ose çdo kushti tjetër të mbrojtur nga ligjet e shtetit.